



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Në bazë të nenit 5, të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (**Ligji i AKP-së**), dhe kapitullit 3, të Politikave Operative të AKP-së, Agjencia Kosovare e Privatizimit ("**AKP**") si administratore me mirëbesim, përcakton statusin e ndërmarrjeve/aseteve në territorin e Kosovës, në bazë të dokumentacionit dhe dëshmimeve në dispozicion. Lidhur me këtë Agjencia për publikun dhe të gjitha palët e interesuara shpallë këtë:

NJOFTIM

Në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të AKP-së të mbajtur më 21 dhe 22 gusht 2017, ky Bord ka marrë Vendim që:

Ndërmarrja "Sar Drvoexport" KK Shtërpce, Prizren, është pronë shoqërore dhe bie nën kompetencat administrative të Agjencisë.

Shënim i rëndësishëm:

Përcaktimi i identitetit të Pronarit është i rëndësishëm për pagesën e të ardhurave nga shitja e ndërmarrjes (ndërmarrjeve) dhe asetëve të tilla të ndërmarrjes së lartpërmendura (pas pagesës së Kreditorëve dhe "punëtorëve të kualifikuar" deri në shumë në të cilën këta persona kanë të drejtë).

Meqenëse AKP nuk është trup kuazi-gjyqësor, palët e interesuara dorëzimin e kërkesave/ankesave kundër vendimit të Bordit të Drejtorëve mund ta bëjnë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ligji përkatës i AKP-së gjendet në faqen e internetit të AKP-së <http://www.pak-ks.org> apo drejtpërdrejtë në <http://www.assembly-kosova.org/>